



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr.68, datë 17.05.2024

PËR  
VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË ZONJËS EMA LAZAJ,  
KANDIDATE PËR MAGJISTRAT PROKURORE, E CILA DO TË DIPLOMOHET  
NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2024

Mbështetur në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 dhe 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 35 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për magjistrat prokurorë zonjës Ema Lazaj, e cila do të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2024”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit të kandidatës për t’u emëruar prokurorë, zonja Ema Lazaj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatës Ema Lazaj.
3. Lejimin e kandidatës Ema Lazaj të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si prokurorë.
4. Të njoftohet për këtë vendim zonja Ema Lazaj dhe Shkolla e Magjistraturës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më datë 17.05.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj



**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**



**ANËTAR**  
**Nurihan Seti**



**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**




**ANËTAR**  
**Ledina Riza**



**ANËTAR**  
**Moisi Duda**



**ANËTAR**  
**Vatë Staka**



**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**